



VENDIM

Nr. 134 Datë 15.11.2013

PËR

**SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË
VENDOSURA NGA ERE SHOQËRISË “E VENTO S.R.L ALBANIA
SH.P.K”**

Në mbështetje të neneve 9, 13 pika 1, gërma “a”, dhe 15 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të Ligjit Nr. 8485, datë 12.05.2008 “Kodi i Proçedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15.11.2013, mbasi shqyrtoi informacionin për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë E Vento s.r.l. Albania Sh.p.k,

Konstatohet se:

Argumentat e shoqërisë janë të drejta dhe gjithashtu duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e investimit dhe me qëllim mbështetjen dhe nxitjen e ndërtimit të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë,

Vendosi:

1. Të shtyjë me 12 muaj afatet e përcaktuara në vendimin Nr. 55 datë 25.08.2010 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE, shoqërisë E Vento s.r.l Albania Sh.p.k”.
2. Ngarkohet Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë shoqërinë për Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE-s

Petrit AHMETI

